

Numri i lëndës:	2023:077484
Datë:	20.02.2025
Numri i dokumentit:	04131426

P.nr.48/2023

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA KLINË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit R G, nga Klina Rr. „MH i akuzuar për shkak të veprës penale „Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit" nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktauzën e Prokurorisë Themelore në Pejë me PP/II nr.2499/2022 e dt. 20.03.2023, në bazë të nenit 357 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, dhe nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt.20.02.2025, maur këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur në ndërmjetësim Nd. nr. 5/2024 në mes të pandehurit, R G dhe përfaqësuesit të palës dëmtuar Kuvendit Komunal në Klinë, S V inspektor në Kuvendin Komunal në K, i mbrojtjes dhe ujrave nga MMPHI.

HUDHET AKTAKUZA: e Prokurorisë Themelore Pejë, me nr. PP/II. Nr. 2499/2022 e dt. 20.03.2023, për të pandehurin R G, nga Klina Rr. „MH" i akuzuar për shkak të veprës penale „Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit" nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, për shkak se, palët ne rastin konkret, në procedurën e ndërmjetësimit kanë arrit marrëveshje dhe pajtim në mes veti me nr. Nd.5/2024 e dt. 20.01.2025.

PUSHOHET: procedura penale në çështjen penale PP/II. Nr. 2449/2022 , për të pandehurin R G

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë me nr. PP/II. Nr. 5/2024 dt. 20.01.2025, për të pandehurin R G, nga K Rr. „M H i akuzuar për shkak të veprës penale „Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit" nga neni 338 par. 1 të KPRK-së,

Ashtu qe në bazë të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokolli 01/66 i dt.29.01.202, e ka referuar rastin për ndërmjetësim.

I pandehuri R G, dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar R G dhe palës dëmtuar S V inspektor në Kuvendin Komunal në Klinë, i mbrojtjes dhe ujrave nga MMPHI kanë arritur marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit me Nd. nr.05/2024 e dt. 25.01.2025

Prokuroria është njoftuar për marrëveshjen e ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit të lartëcekur.

Gjykata në bazë të nenit 15 të ligjit për ndërmjetësim të Kosovës e ka aprovuar marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim në mes të pandehurit, si dhe palës së dëmtuar, për shkak të arritjes së marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata bazë të nenit 358 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, nenit 232 të KPPK-ës, nenit 2 paragraf 2, nenit 8 lidhur me nenin 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokollit 01/66 i dt.29.01.202, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt. 30.01.2024 ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA KLINË
P.nr. 48/2023 dt, 20.02.2025

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankese në afat prej tre (8) dite drejtuar gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

